

## STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"VD CONSTRUCTION" Sh.P.K

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### FORMIMI I SHOQËRISË

NENI I

Sot në Korçë në datën 11/03/2024 (dymije e njëzet e katër) themelohet shoqëria tregtarë me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "VD CONSTRUCTION" Sh.P.K, me vullnetin e lirë të ortakeve ,në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare", formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " VD CONSTRUCTION" Sh.P.K, nga ortakët themelues :

❖ **VINJOL DEMIRI** shtetas shqiptar , i datëlindjes 11/03/1984, lindur në Plasë,Maliq, madhor me zotësi të plota për të vepruar me NID I40311027I dhe Numer pashaporte BG7926353

Te cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare", si dhe Aktin e Themelimit kanë vendosur të destinojnë në këtë sipërmarrje kapitalin e tyre ,me qëllim që të përfitojnë të ardhura,që mund të vijne nga veprimitaria e shoqërisë si dhe të përballoje humbje deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.

Shoqëria ushton veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë të tregut të lirë.Shoqëria tregtare "VD CONSTRUCTION" fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë Zyrës së Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

### FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË

NENI 2

- 1.Shoqëria tregtare është organizuar si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 2.Ernertimi i shoqërisë është:"VD CONSTRUCTION" Sh.P.K
- 3.Në rast transferimi të veprimitarisë tregtare, mund të ruhet i njëjtë emërtim, me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

## SELIA E SHOQËRISË

### NENI 3

1. Shoqëria tregtare "VD CONSTRUCTION" Sh.P.K e ka selinë qëndrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në fshatin Plasë , Maliq në adresën: "Dëshmorët e Plasës" 02470024,Nd 67,H 1,Pojan Plasë,Maliq 7014
2. Shoqëria mund të krijojë qëndra sekondare.filial, zyra përfaqësimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.
3. Shoqëria mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqeri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit te Republikës së Shqipërisë. Njësia strukturore e shoqërisë në format e mësipërme, do të krijohet në përputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

### KOHËZGJATJA

### NENI 4

Shoqëria tregtare "VD CONSTRUCTION" Sh.P.K do të përrnbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat te pacaktuar.

Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë dhe përcaktime te mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasoje Krijimin e një Personaliteti te ri Juridik.

### OBJEKTIVI I VEPRIMTARISË

### NENI 5

Objekti i shoqerise "VD CONSTRUCTION" Sh.P.K do te jete: Ne fushen e ndertimit ne punime beton arme.Konstruksione beton arme,punime karpentieri,pergatitje dhe vendosje e hekurit te ndertimit ne konstruksione betoni.Ndertim i impianteve (punime beton arme) te trajtimit te ujrale ndotura.Ndertimi i depove te ujit te pijshem.Ndertimi i hidrovoreve.Punime beton arme ne HEC-e.

### TË DREJTAT E SHOQËRISË

### NENI 6

Shoqeria tregtare "VD CONSTRUCTION" Sh.P.K nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko - tregtare apo industriale ,që ortaket zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj. Shoqeria mund të ndryshojë emrin , selinë, kohëzgjatjen, objektin e veprimtarisë,administratorin, sipas vendimeve ,që do të marrin ortaket.

### KAPITALI I SHOQËRISË

### NENI 7

Kapitali themeltar i shoqërisë perbehet nga 100.000 lekë (njëqind mijë lekë) i cili eshte tëresisht kapital financiar.Kapitali themeltar është kuotë me vlere nominale :100.000 ( njëqind mijë lekë)

Kapitali themeltar zoterohet nga ortaku i vetëm ;

I. **VINJOL DEMIRI**, zoterues i 1 (një) kuote apo 100% i kapitalit të shoqërisë.

Ortaket kanë të drejtë të tjeterojnë, të zmadhojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuar nga ligji.Kapitali fillestas nuk eshte paguar.

#### NENI 8

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të veçanta, të financimit per zhvillimin ekonomik - tregtar.

#### NENI 9

I.Përberja e kapitalit të shoqërisë fondet e krijimit te saj si dhe përdorimin e rregullimit të cdo fondi të veçante përcaktohen nga ortaket sipas te drejtave dhe detyrave të caktuara në statut.

2.Të ardhurat e përgjithshme të shoqërisë dhe në përgjithësi çdo operacion financier' i saj do të pasqyrohen në kontabilitetin e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe në rnbështetje të akteve përkatese te rrjedhura prej tij.

#### NENI 10

Shoqëria tregtare "VD CONSTRUCTION" Sh.P.K është pronare e pasurisë së saj të cilën e përdor dhe e disponon në emer të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë të shoqërisë.

1.Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale në përputhje me legjislacionin përkates shqiptar.Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike dhe juridike do të paguhën nga fondet e shoqërisë.

#### NENI 11

I. Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në monedhë shqiptare. (LEK)

2.Aktiviteti financial' i shoqërisë do të mbylljet në 31 dhjetor të çdo viti dhe bilanci do të miratohet brenda tre muajve të vitit në vazhdim.



3.Llogaritë vjetore , inventari, raportet dhe operacionet e vitit finansiar' , rapportet e vecanta të hartuara nga ortakët dhe nese e kërkon ligji nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim të ortakeve të saj.

NENI 12

1.Pjesët e kapitalit themeltar janë lirshëm të transferuar në rrugë trashegimie.

NENI 13

I.Trasferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes, personave përfitues, do të bëhet pasi ata të pranojnë përbajtjen e statutit të kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që mund të ketë pasuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar bëhen të trasferueshme.

NENI 14

I.Në rast mospranimi, pjesët e kapitalit themeltar, mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e ortakëve.

NENI 15

I.Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në para dhe në natyrë apo i vogelimi të tij bëhet me Vendimin e Ortakëve të shoqërisë mbi bazën e një projekti të paraqitur nga ekonomisti i firmës apo nga një ekspert kontabël i miratuar.

KREU I DYTE

ORTAKERIA

NENI 16

I.Ortakët e shoqërisë tregtare "VD CONSTRUCTION" Sh.P.K gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në Legispcionin e Republikës së Shqipërisë, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e shoqërisë.

Të drejtat dhe detyrat e ortakeve :

NENI 17

1.Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së ortakëve duke ushtruar të drejtën në votën e tij.

2.Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit.

3.Të infomohet mbi përrnbajtjen e raportit të administrimit, inventaret , e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel.

4.Të përfitojë nga fitimi i shoqerisë.

5.Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara.

### KREU I TRETE

#### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 18

1.Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqerisë , asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik , të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqeria ose largohen me dëshirën e tyre.

Administratori i emeruar i ka te gjitha kompetencat për të vepruar në emer të shoqërisë me përjashtim të rasteve të veçanta që ligji i jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori i shoqerise emërohet:

### Z.VINJOL DEMIRI

Të cilët përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhene me të tretë për një periudhe 5 ( pesë ) vjeçare dhe me të drejtë rizgjedhje.

2. Administratori mund t'ja delegoje kompetencat e tij me shkrim në forrnen e autorizimit ose me prokurë.

3.Shoqeria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjeter, i cili emërohet me vendim të Ortakëve.

### ASAMBLEJA

NENI 19

1. Asambleja e ortakëve është organi me i lartë vendimmarrës rshoqërise
2. Ortakët mund t' i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit me prokurë.
3. Cdo klauzolë e kundert është e pavlefshme në këtë rast.

NENI 20

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë :

1.Të hartojë dhe të miratoje ndryshimet në Statut

- 2.Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë.
- 3.Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 4.Të emerojë dhe të shkarkojë administratorin e shoqërisë
- 5.Të shpallë prishjen, likujdimin, dhe falimentimin e shoqërisë.
- 6.Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë.
- 7.Të miratojë marëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj.
- 8.Të miratojë strukturat e shoqërisë
- 9.Cdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
10. Proçes verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

## TE DREJTAT E ADMINISTRATORIT

### NENI 21

Administratori ka keto te drejta:

1. Të përfaqësojë shoqerinë në marrëdhieniet e saj me të tretët , e me administratën publike.
2. Të emeroje pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojiten asaj në perrnbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik.
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës së Republikës së Shqipërisë.
4. Të administrojë pasurinë dbe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Asambleja e Ortakeve.
5. Të testojë aftësinë e punonjësve në administratë.
6. Të thërras Asamblenë e Ortakëve dhe të propozojë çështje që duhen analizuar.
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdc vit pasues dhe të vendosë e te ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët.
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe ti paraqesë atë për miratim nga asambleja e Ortakeve.

### NENI 22

Administratori është përgjegjes individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

### NENI 23

I.Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licensuar dhe kur kërkohet nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.

2.Për emërimin , kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë , zëvendesueshmërinë, térheqjen, shkarkimin, dhe shpérblimin e tij, zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

#### NENI 24

1.Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të se cilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislaionin shqiptar në këtë fushë.

2.Marrija në punë bëhet me rregjistrim në Librin e Punës së Shoqërisë si dhe duke njoftuar organet e Punës së juridiksonit ku ushtron aktivitetin shoqëria,

3.Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit.Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë ,do të zgjidhen me mirëkuptim të paleve të cilët për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqesues me prokurë.Kur mirëkuptirni nuk është i mundur palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor,

#### FORCAT MADHORE

#### NENI 25

1.Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftësi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund t'i shmangen me masa të arsyeshme.

2.Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakëve.

3.Kur ortakët ndodhen në paaftesi të plotësojnë detyrimet e tij per arsyen te forcave madhore , ne baze te kontrates dhe statutit duhet te bejne çdo perpjekje qe ta kapercejne kete veshtiresi,

#### SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

#### NENI 26

Shperndarja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per ç fardo shkaku. Shoqeria mund te prishet para kohe:

-Me vendim te ortakeve

-Kur mbaron kohezgjatja e shoqerise

-Pas dy viteve te veprirntarise me bilane negative (humbje)

-Me vendim te gjykates ose per arsyen te tjera te parashikuara ne Statut

-Ne rast mbyllje ortaket vendosin mbi menyrat e likujdimit dhe caktojne një ose me shume likujdatorë duke ju percaktuar dhe detyrat.Ne rastin e likujdimit , emërtimi i shoqërisë do të shoqerohet nga shenimi "Shoqëri ne likujdim"



Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likujdimit dhe kryhen formalitetet e duhura , shoqëria çrregjistrohet nga Regjistri Tregtar i Qëndrës Kornbëtare te Biznesit.

#### BAZAT LIGJORE

NENI 27

E gjithe veprimitaria e shoqerise do te bazohet ne ligjin 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

#### RRUAJTJA E SEKRETIT

NENI 28

Ortaket detyrohen qe te mos nxjerrin tek te tretet te dhena dhe njoftime secrete qe kane te bejne me veprimitarine ekonomike te shoqerise.

Ortaket e shoqerise percaktojne llojin e te dhenave dhe informative qe konsiderohen secrete.

#### DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 29

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut do te aplikohet Ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe Legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 30

Ky Statut hyn ne fuqi diten e rregjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar ne Qendren Kornbetare te Biznesit.

NENI 31

I.Ky Statut perpilohet ne 5 (pese) kopje originale secili me te njejten vlere ligjore.

2.Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise

Ky statut hyn ne fuqi diten e rregjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar ne Qendren Kornbetare te Biznesit

Ortaku i vetem

Vinjol DEMIRI

